



*Pasqyrat financiare*

*për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021*

**PËRMBAJTJA**

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR .....	3
PASQYRA E PERFORMANCËS .....	4
PASQYRA E LËVIZJEVE TË PARASË .....	5
1. Informacion i përgjithshëm .....	6
2. Bazat e përgatitjes .....	6
3. Politikat e përgjithshme kontabël .....	6
4. Mjetet monetare .....	7
5. Llogari të arkëtueshme .....	8
6. Aktive të qëndrueshme .....	8
7. Të pagueshme .....	8
8. Detyrime të tjera .....	8
9. Grante .....	8
10. Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit .....	9
11. Shpenzime nga aktivitetet .....	9
12. Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme .....	9
13. Rezultati neto i vitit financiar .....	9

**ICC ALBANIA**

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021  
 Vlerat në Lekë

- 3 -

**PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR**

	Shënime	2021	2020
<b>AKTIVET</b>			
Mijete monetare dhe ekuivalentet e tyre	4	3,255,214	7,143,369
Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm	5	1,881,849	1,222,684
Investime të tjera afatgjata	6	161,531	6,541
<b>Totali i Aktiveve</b>		<b>5,298,594</b>	<b>8,372,594</b>
<b>DETYRIMET</b>			
Të pagueshme	7	2,239,564	2,272,338
Të tjera detyrime	8	189,249	168,836
Kontribute të marra në avancë			
Grante	9	2,382,828	4,642,421
<b>Totali i Detyrimeve</b>		<b>4,811,641</b>	<b>7,083,595</b>
<b>AKTIVET NETO</b>			
Të pakufizuara		486,953	1,288,999
<b>Totali i Aktiveve Neto</b>		<b>486,953</b>	<b>1,288,999</b>

Bilgen ALDAN  
 Kryetari i Bordit Drejtues

*Bilgen Aldan*  
*[Signature]*



*Ardita Seknaj*  
*[Signature]*

Ardita SEKNAJ  
 Sekretar i Përgjithshëm

*Andi Pacani*  
 Andi PACANI  
 Kontabël i Miratuar

**ICC ALBANIA**

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

Vlerat në Lekë

- 4 -

**PASQYRA E PERFORMANCËS**

	Shënime	2021	2020
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara:			
<b>Të ardhurat:</b>			
Të ardhura nga tarifat e anëtarësimit		3,268,365	1,860,630
Te ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci te tjera te financimit		2,259,593	2,764,117
Të ardhura të tjera		179,000	31,897
<b>Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara</b>	10	<b>5,706,958</b>	<b>4,656,644</b>
<b>Shpenzime për aktivitetet</b>			
Aktivitetet e ICC Albania	11	(186,987)	(426,305)
Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme	12	(4,062,424)	(3,406,247)
Shpenzime per projekte	9	(2,259,593)	(2,764,117)
<b>Totali i shpenzimeve</b>		<b>(6,509,004)</b>	<b>(6,596,669)</b>
<b>Rritja/Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)</b>		<b>(802,046)</b>	<b>(1,940,025)</b>
Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara:			
Kontributet		-	-
Aktivete neto te çliruara nga kufizimet (me shenje minus)		-	-
<b>Rritja/Rënia në aktivet neto përkohësisht të kufizuara (B)</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Ndryshimi në aktivet neto (A + B)</b>		<b>(802,046)</b>	<b>(1,940,025)</b>
Aktive neto në fillim të vitit		1,288,999	3,229,024
<b>Aktive neto në fund të vitit</b>		<b>486,953</b>	<b>1,288,999</b>

**PASQYRA E LËVIZJEVE TË PARASË**

	2021	2020
<b>AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT</b>		
<b>Ndryshimet në aktivet neto</b>	<b>(802,046)</b>	<b>2,702,396</b>
Rregullimet:		
Amortizimi dhe zhvlerësimi	24,010	2,180
Kontributet e kufizuara për investime në dhurime / ndihma	(2,259,593)	-
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:		
Të tjera të arkëtueshme	(659,165)	339,245
Të pagueshme	(12,361)	(16,724)
<b>Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit</b>	<b>(2,907,109)</b>	<b>324,701</b>
<b>AKTIVITETET INVESTUESE</b>		
Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata (Dhurate)	(179,000)	-
<b>Flukse neto nga aktivitetet investuese</b>	<b>(179,000)</b>	<b>-</b>
<b>Rritje / Rënie neto e mjeteve monetare dhe ekuivalenteve të tyre</b>	<b>(3,888,155)</b>	<b>3,027,097</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në fillim të periudhës</b>	<b>7,143,369</b>	<b>4,116,272</b>
<b>Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në fund të periudhës</b>	<b>3,255,214</b>	<b>7,143,369</b>

## **SHËNIME**

### **1. Informacion i përgjithshëm**

Komiteti Kombëtar për Shqipërinë i Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (më poshtë "ICC Albania") është një organizatë jo-fitimprurëse në Shqipëri.

ICC Albania është regjistruar me Vendim Gjykate nr. 3407, datë 4.10.2012, është pajisur me NIPT L22222451Q dhe ka adresë pranë Bankës Kombëtare Tregtare, Bulevardi. "Zhan D'Ark", Tiranë, Shqipëri.

ICC Albania ndjek veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse". Aktiviteti i ICC Albania, si një organizatë jofitimprurëse, nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri.

ICC Albania ka patur 1 punonjës më 31 dhjetor 2021 (2020: 2).

### **2. Bazat e përgatitjes**

#### **2.1 Deklaratë e përputhjes me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara**

ICC Albania mban regjistrimet kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin kontabël dhe tatimor në Shqipëri. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të Organizatave Jofitimprurëse (SKK për OJF).

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara. Nga 1 janar 2016, me hyrjen në fuqi të SKK për OJF, pasqyrat financiare janë hartuar bazuar mbi këtë standard.

#### **2.2 Bazat e vlerësimit**

Pasqyrat financiare u përgatitën në bazë të parimit të kostos historike.

#### **2.3 Monedha funksionale dhe ajo raportuese**

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare janë vlerësuar në monedhën shqiptare Lekë. ICC Albania raporton pasqyrat financiare në Lekë.

### **3. Politikat e përgjithshme kontabël**

Politikat kontabël që janë prezantuar më poshtë janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

#### **3.1 Aktive afatgjata materiale**

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Amortizimi për paisjet informatike njihet në fitim ose humbje me metodën e vlerës së mbetur me një normë prej 25% në vit.

## ICC ALBANIA

Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

Vlerat në Lekë

- 7 -

### 3. Politikat e përgjithshme kontabël (vazhdim)

#### 3.2 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën funksionale të ICC Albania sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e këmbimit të lindura nga shlyerja ose raportimi i një zëri monetar të njohur fillimisht me një kurs tjetër këmbimi janë ngarkuar tek zëri specifik i pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### 3.3 Kërkesa për arkëtim

Kërkesat për arkëtim njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të pakësuara për humbjet për zhvleresime.

#### 3.4 Mjetet monetare

Aktivitet monetare përbëhen nga gjendja në arkë dhe në llogaritë bankare.

#### 3.5 Detyrime tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe të tjera janë paraqitur me koston e tyre.

#### 3.6 Të ardhurat

Të ardhurat njihen kur përfitohen.

#### 3.7 Shpenzimet

Shpenzimet njihen kur ato ndodhin.

#### 3.8 Vazhdimësia gjatë COVID-19

Përhapja e Coronavirus (COVID-19) në janar 2020 dhe zgjerimi i saj në një numër të madh vendesh bëri që shpërthimi i virusit të klasifikohej si një pandemi nga Organizata Botërore e Shëndetësisë në 11 Mars 2020. Pasojat e COVID-19 nuk krijojnë pasiguri që hedh dyshime mbi aftësinë e subjektit për të vazhduar aktivitetin e saj. Në datën e përgatitjes së këtyre pasqyrave financiare, subjekti vazhdon të përmbushë detyrimet e saj dhe për këtë arsye ajo vazhdon të zbatojë parimin e vazhdimësisë për përgatitjen e pasqyrave financiare.

### 4. Mjetet monetare

ICC Albania operon me disa llogari bankare në Euro dhe në Lekë të çelura pranë tre bankave te nivelit te dyte ne vend. Në fund të vitit balancat në bankë dhe arkë rezultojnë si më poshtë:

*Arka dhe banka përbëhen nga sa më poshtë:*

Mjete monetare	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Banka	3,231,613	7,134,653
Arka	23,601	8,716
<b>Totali</b>	<b>3,255,214</b>	<b>7,143,369</b>

**ICC ALBANIA****Pasqyrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021****Vlerat në Lekë**

- 8 -

**5. Llogari të arkëtueshme**

Ky zë detajohet si më poshtë:

Klientë	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Kuotë anëtarësimi	1,638,210	1,022,340
Të tjera	243,639	200,344
<b>Totali</b>	<b>1,881,849</b>	<b>1,222,684</b>

**6. Aktive të qëndrueshme**

ICC Albania ka blerë një printer në Korrik të vitit 2014 në vlerën 42,000 Lekë. Gjithashtu, në korrik 2021 ka përfituar disa pajisje zyre dhurate. Më poshtë jepet vlera bruto dhe amortizimi akumuluar në fund të cdo viti:

Aktive të qëndrueshme	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Vlera bruto (printer)	36,750	36,750
Vlera bruto (pajisje dhurate)	179,000	-
Amortizimi akumuluar	(54,219)	(30,209)
<b>Vlera neto</b>	<b>161,531</b>	<b>6,541</b>

**7. Të pagueshme**

Ky zë detajohet si më poshtë:

Të pagueshme	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Telefon	2,908	2,500
Furnitorë të tjerë	2,236,656	2,269,838
<b>Totali</b>	<b>2,239,564</b>	<b>2,272,338</b>

**8. Detyrime të tjera**

Ky zë detajohet si më poshtë:

Detyrime të tjera	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
TAP, sigurime shoqërore dhe shëndetësore	57,491	62,892
Paga të pagueshme	131,758	105,944
<b>Totali</b>	<b>189,249</b>	<b>168,836</b>

**9. Grante**

Ky zë detajohet si më poshtë:

Grante	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Gjendja në fillim	4,642,421	7,406,538
Shuma e perdorur	(2,259,593)	(2,764,117)
<b>Totali</b>	<b>2,382,828</b>	<b>4,642,421</b>



**ICC ALBANIA**

Pasqrat financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021

Vlerat në Lekë

- 9 -

**10. Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit**

Ky zë përfaqëson kuotat e anëtarësisë të paguara nga anëtarët e ICC Albania, të ardhurat nga seminare, sponsorizime, publikime dhe të ngjashme, si edhe fitimi i rezultuar nga diferencat në kurset e këmbimit.

Të ardhurat	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga kuotat e anëtarësisë	3,268,365	1,860,630
Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit	2,259,593	2,764,117
Të ardhura të tjera (dhurimi i pajisjeve)	179,000	31,897
<b>Totali</b>	<b>5,706,958</b>	<b>4,656,644</b>

**11. Shpenzime nga aktivitetet**

Këto janë shpenzimet e kryera nga ICC Albania për zhvillimin e aktiviteteve të saj specifike jo-fitimprurëse:

Shpenzime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Aktivitetet e ICC Albania	186,987	426,305
<b>Totali</b>	<b>186,987</b>	<b>426,305</b>

**12. Shpenzime administrimi dhe të tjera të përgjithshme**

Ky zë përfshin shpenzime për pagat, për anëtarësim si edhe shpenzime të tjera administrative, si më poshtë:

Shpenzime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Shpenzime paga	2,485,450	1,810,603
Shpenzime anëtarësie	643,530	618,500
Shpenzime të tjera administrimi	1,067,987	1,080,159
Fitim nga kurset e këmbimit	(134,543)	(103,015)
<b>Totali</b>	<b>4,062,424</b>	<b>3,406,247</b>

**13. Rezultati neto i vitit financiar**

ICC Albania, në fund të vitit 2021, nuk ka në disponim aktive të kufizuara (2020: zero). Aktivet e kufizuara vijnë në formën e kontributeve, përdorimi i të cilave është specifik për projektin, prandaj kategorizohen si aktive neto të kufizuara. Rezultati neto i vitit financiar paraqitet si më poshtë:

Rezultati neto i vitit financiar	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2021	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2020
Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara	(802,046)	(1,940,025)
Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara	0	0
Rezultati neto i vitit financiar	(802,046)	(1,940,025)
<b>Totali</b>	<b>(802,046)</b>	<b>(1,940,025)</b>

\* \* \* \* \*